REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 329/20
Datë/Datum. 12.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	05.06.2020	12.06.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.05.2020, OE "BK Construction", ka parashtruar ankesë me nr: 329/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Serena", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi i gypit te vjeter te AC, Dn 200 te ujesjellesit jugor" me nr. të prokurimit: 19-9346-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Hidrodrini Sh.A - Pejë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 119,986.53€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 06.12.2019, data e hapjes së ofertës: 30.12.2019, data e vendimit për dhënien e kontratës: 08.05.2020, data e njoftimit të ofertuesve me leter standarde: 08.05.2020.
Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues ne ankesen e tij ka nje pretendim ankimore lidhur me oferten e te rekomanduarit per kontrate per te cilin pretendon se i njejti nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit konkretishte kerkesen lidhur me Inxhinirin e diplomuar te Gjeodezise dhe se me kete rast AK-ja, gjate vleresimit ka bere shkelje te dispozitave te nenit: 69 te LPP-se dhe nenit 39 te RrUOPP-se (ku thuhet CV e dorezuar nuk permbush kerkesat ateher refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem).

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kerkesa Nr.2 OE në kuadër të stafit duht të këtë:

- Një Inxh te drejtimit Gjeodezis ..... 3 vite, pervoje pune.

Inxhinierat duhet te jane të diplomuar drejtimeve larte cekur, me së paku tri vite pune në profesion e dëshmuar me diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën në punë, të jenë në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi për këtë project.

Deshmija per kerkesen Nr.2 Lista e stafit ku janë të përfshirë stafi i kërkuar, të bashkangjitur edhe CV, diplomën , dëshmi mbi përvojën e punes, si dhe kontratën e punës ose të bashkëpunimit për këtë projekt (per Stafin e kerkuar).

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Sipas raportit te vleresimit te dy operatoret ekonomik jane te pergjegjshem.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sa i perket pretendimit te OE ankues, se i rekomanduari per kontrate nuk e ka plotesuar kerkesen e dosjes se tenderit lidhur me Inxhinierin e Gjeodezise, me arsyetimin se OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar diplom te Inxhinierit te Gjeodezise me grad te Bachelor-it dhe se sipas OE ankues nuk eshte e njejta grad e diplomes me ate qe ka kerkuar AK-Hidrodrini ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kerkesen e dosjes se tenderit, vlereson se pretendimi i OE ankues eshte i paqendrueshem per faktin se, AK-ja, ne dosje te tenderit nuk ka kerkuar grad Bachelor ose Master.
Ne kerkesen e dosjes se tenderit lidhur me inxhinierin e lartpermendur thuhet vetem se i njejti duhet te jet i drejtimit te Gjeodezise dhe i diplomuar me 3 vite pervoje pune dhe nuk permenden gradat Bachelor apo Master.

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me CV-in per te cilen pretendon se CV e inxhinierit te gjeodezise nuk i permban te dhenat e nevojshme, eksperti shqyrtues fillimishte sqaron se OE i rekomanduar per kontrate me rastin e aplikimit ne kete aktivitet te prokurimit nuk e ka dorezuar ne oferten e tij CV-in e inxhinierit te Gjeodezise dhe per te njejten AK-ja gjate vleresimit ka kerkuar sqarim nga OE i rekomanduar per kontrate dhe i njejti e ka dorezuar CV-in e Inxhinierit te lartpermendur.

Eksperti shqyrtues, ne vazhdim sqaron se ne CV-in, e inxhinierit eshte dhene pervoja e punes prej vitit 2010 deri ne vitin 2016 ne kompani te ndryshme dhe per te njejtat ka dorezuar edhe referenca si gjeodet, por te njejtat nuk mund te merren parasysh per faktin se data e diplomimit te inxhinierit te Gjeodezise eshte Korrik 2015 dhe nuk mund te merret si pervoje profesionale per faktin se nuk ka qene i diplomuar si inxhinier.
Poashtu lidhur me pervojen e inxhinierit te Gjeodezise ne CV, eshte shenuar se ky inxhinier prej vitit 2016 punon ne nje kompani tjeter po qe nuk ka te dhena te mjaftushme, se sa ka punuar ne kete kompani dhe nuk ka dorezuar as reference nga kjo kompani, reference me te cilen do ta mbulonte per faktin se diplomimi i Inxhinierit te Gjeodezise eshte Korrik 2015 dhe vetem nga ajo date mund te llogaritet pervoja profesionale.

Prandaj, pretendimi i OE ankues lidhur me deshmit e lartpermendura qendron per faktin se ne CV e Inxhinierit te gjeodezise mungojne te dhenat e nevojshme per ta vertetuar pervojen e Inxhinierit te lartpermendur, andaj konform nenit 39 RrUOPP-se pikes 10 te tabeles se dhene ne kete nen eshte dashur qe oferten e te rekomanduarit per kontrate ta refuzoje per faktin se perkunder mundesise se dhene per sqarim nga AK-ja, OE i rekomanduar per kontrate nuk ka arritur te deshmoje se i njejti e ploteson kerkesen lidhur me pervojen e inxhinierit te Gjeodezise, pra CV-ja e dorezuar nuk e permbush kerkesen e AK-se.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjeserisht e bazuar, ndersa vendimi i AK-se, per dhenie te kontrates te anulohet dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – HIDRODRINI Sh.A.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - BK CONSTRUCTION.

Agon BLAKAJ

Phone: +377(0) 44 – 568-784

+386(0) 49 – 487-411

blakajagon@gmail.com

Datëlindja
20 Korrik 1990

-Edukimi
2009- Universiteti i Prishtines, Fakulteti i Ndërtimtaris dhe Arkitektures - drejtimi Gjeodezi - **I Diplomuar**

-Nga 01.10.2015 (Cand. Msc. Geo)

-Pervoja
-Nga 02.02.2010
Gjeodet në kompaninë gjeodete **"GEOPRO "** Prishtinë

1. Identifikimi i parcelave,
2. Ndarja e parcelave kadastrale ,
perkufizimi i pikave ndarese ndermjet ngastrave kadastrale.
3. Rilevime Gjeodezike ,
4. Analiza e te dhenave analoge grafike dhe tekstuale
5. Puna me Total Stacion dhe GPS

-Nga 11.06.2012-11.12.2012
Gjeodet ne projektin **Change4Kosovo**, Agjensioni per Regjistrim Civil dhe Sistem te Unifikuar te Adresave

-Nga 01.01.2013-15.12.2015
Gjeodet ne kompaninë gjeodezike **"GEO-MAP"**

Zbatimi I projektit: 1)Krijimi i Kadastrit te perqojave dhe objekteve nentoksore ne komunen e Prishtinës dhe Mitrovices
2)Inqizimi I hapsirave te perbashketa banesore ne komunen e Prishtinës
3)Punë inxhinierike dhe kadastrale

-Nga 20.02.2016 –
Gjeodet ne kompaninë **"AL TRADE HOLDING"**

-Shkathtësitë kompjuterike : -Microsoft Office : Word, Excel, PowerPoint
-AutoCad Civil 3D
- Geomedia
-Arc GIS

-Gjuhët e huaja : Angleze